

VENDIM
Nr.730, datë 28.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË ARMATIMIT, TË LËNDËVE KIMIKE
(NEUROPARALIZUESE) DHE TË MJETEVE TË TJERA, TË PËRDORIMIT TË FORCËS
NGA POLICIA E SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve kimike (neuroparalizuese) dhe të mjeteve të tjera, të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit, të klasifikuara sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Plotësimi organik me armatim, me lëndë kimike (neuroparalizuese) dhe mjete të tjera, të përdorimit të forcës nga policia, bëhet në funksion të misioneve të përcaktuara për çdo strukturë të Policisë së Shtetit.

3. Tabela e organizimit të armatimit, të lëndëve kimike (neuroparalizuese) dhe të mjeteve të përdorimit të forcës nga policia, rregullat për ruajtjen, mirëmbajtjen, shpërndarjen dhe përdorimin e tyre përcaktohen me urdhër të Ministrit të Brendshëm, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

4. Ngarkohet Ministria e Brendshme të hartojë planet për zëvendësimin, në të ardhmen, të armatimit, lëndëve kimike (neuroparalizuese) dhe mjeteve të tjera, të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit, në përputhje me standardet e BE-së.

5. Vendimi nr.8, datë 12.1.2001 i Këshillit të Ministrave “Për pajisjen me mjete teknike dhe armatim të punonjësit të policisë”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PASQYRA NR.1

**ARMATIMI, LËNDËT KIMIKE (NEUROPARALIZUESE) DHE MJETET E TJERA TË
PËRDORIMIT TË FORCËS NGA POLICIA**

Armë zjarri policore pistoletë kalibër 9x19m/m
Municion policor për pistoletë kalibër 9x19m/m
Armë zjarri policore të gjata kalibër 9x19m/m me qitje një nga një dhe automatike
Municion për armë zjarri të gjata kalibër 9x19m/m
Pushkë me precizion të lartë dhe me shënjestër optike për ditën dhe natën dhe me qitje një nga një dhe gjysëm automatike
Shotgan 12mm.
Municion policor kalibër 12m/m me saçme gome, me gaz, me plumb
Shotgan 37x40mm
Municion policor 40m/m me saçme gome, me gaz, me plumb dhe me eksploziv
Armë të ftohta
Bombola me gaz CN
Bllokues rrugësh
Jelek antiplumb të nivelit III NIJ Standard 0101.04 dhe të mbrojtë nga municionet 7.62x25 mm me shpejtësi fillestare 410m/s e lart
Pllaka antiplumb të nivelit IV NIJ Standard 0101.04 dhe të mbrojtë nga municionet 7.62x39mm, 7.62x45mm, 7.62x54mm, 7.62x54mm me shpejtësi fillestare 710mm/s e lart

Mburoja kolektive antiplumb
Kaskë antiplumb
Kaskë policie
Mburojë policie
Mjete për zhytje në ujë
Granata akustike
Granata me gaz CN
Lëndë plasëse eksplozive për shpërthim dyersh
Prerës hidraulik
Shpërthyes dyersh hidraulik
Sprajt lotsjellës, gaz lotsjellës (tubet)
Hekura lidhës me mbajtëse
Shkop gome
Shkop metalik me gjatësi të ndryshme
Jelek me mbishkrimet “POLICIA”